

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

Nr. Rendor	Data e kërkesës	Objekti i kërkesës	Data e përgjigjes	Përgjigje	Mënyra e përfundimit të kërkesës	Tarifa
1	03.01.2024	A.K. – Kërkesë për informacion	04.01.2024	<p>Në bazë të nenit 12, pika 2, të Ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, pranë Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, është depozituar shkresa nr. 6549/3 Prot., datë 28.12.2023 e Këshillit të Lartë Gjyqësor (protokolluar pranë kësaj gjykate me nr. 02 Prot., datë 03.01.2024), me lëndë “Kërkesë për informacion”, lidhur me “Kërkesën për informacion” të z. A.K.</p> <p>Kjo kërkesë është regjistruar nga Specialisti për Marrëdhëniet me Publikun dhe Median në Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve, me nr. 01 rendor, më datë 03.01.2024.</p> <p>Për trajtimin e kërkesës së kërkuarit z. A.K. me përshkrimin e detajuar si vijon: “...Kërkojmë si informacion: Numrin e çështjeve të organizuara me short manual ku sistemi elektronik i menaxhimit të çështjeve nuk ka funksionuar...”, Specialisti për Marrëdhëniet me Publikun dhe Median u konsultua me të dhënat e sistemit të menaxhimit të çështjeve, sipas kërimit.</p> <p>Sa më lart, në zbatim të neneve 3, 10, 12 të Ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, Ju përcjellim informacionin se: Për çështjet e regjistruara në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, përgjatë periudhës kohore të viteve 2018 – 2019 - 2020 – 2021 - 2022 – 2023, nuk ka asnjë rast të formimit të trupit gjykues me procedurën e shortit manual, për arsye të mosfunksionimit të sistemit të menaxhimit të çështjeve.</p>	Përfunduar	Nuk ka
2	08.01.2024	F.B. – Kërkesë për informacion	08.01.2024	<p>Në adresën e emailit zyrtar të Specialistit për Marrëdhëniet me Publikun dhe Median / Koordinatorit për të Drejtën e Informimit të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, më datë 06.01.2024, ora 14:35, është depozituar kërkesa me objekt “Kërkesë për informacion”, nga kërkuar z. F.B.</p> <p>Kjo kërkesë është regjistruar në Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve, me nr. 02 rendor, më datë 08.01.2024.</p> <p>Sipas nenit 46 të Ligjit 98/2016 “Për Organizimin e Pushtetit Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, si dhe nenit 1 të Ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, Specialisti për Marrëdhëniet me Publikun dhe Median / Koordinatorit për të Drejtën e Informimit trajton kërkesat që lidhen me të drejtën e njohjes me informacionin që prodhohet ose mbahet nga autoritetet publike, të cilat kanë për qëllim garantimin e njohjes së publikut me informacionin, në kuadër të ushtrimit të të drejtave dhe lirive të individit në praktikë, si dhe të formimit të pikëpamjeve për gjendjen e shtetit e të shoqërisë.</p> <p>Nisur nga sa më lart, pas trajtimit të kërkesës së paraqitur, në zbatim të neneve 3, 7, 10, 17 të Ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, neneve 3 dhe 5 të ligjit nr. 9887/2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, udhëzimit nr. 4059/2, datë 07.06.2016 “Për anonimizimin e të dhënave personale në vendimet gjyqësore që publikohen në portalin elektronik të gjykatave”, të Ministrit të Drejtësisë, si dhe udhëzimit nr. 15, datë 23.12.2011 “Për përpunimin dhe publikimin e të dhënave personale në sistemin gjyqësor” të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, lidhur me kërkimin për "vendimin e themelit për A.Ç. dhe pjesëtarët e bandës së tij, me konkretisht vendimi nr. 53 akti, datë 14.09.2023", bashkëlidhur gjeni:</p> <ul style="list-style-type: none"> • vendim nr. 53, datë 15.11.2023 të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. 	Përfunduar	Nuk ka